

**VENDIM**  
**Nr. 735, datë 5.11.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 54, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURËS DHE MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË SHTETËRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe të neneve 784 e 801, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 5, të kreut I, “Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në shkronjën “dh”, fjalët “... 2 (dy) milionë euro ...” zëvendësohen me “... 100 000 000 (njëqind milionë) lekë ...”.

b) Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) zgjatja e afatit të kontratës së qirasë për kontratat e lidhura me afat më pak se përcaktimet në pikën 6, të këtij kreu, kur subjektet qiramarrëse kanë realizuar kushtet e kontratës.”.

2. Shkronja “ç”, e pikës 1, të kreut II, “Procedurat e dhënies me qira ose enfiteozë të pasurisë shtetërore”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Genplanin e objektit, në 6 (gjashtë) kopje origjinale, të hartuar nga eksperti topograf i licencuar dhe të konfirmuar nga drejtuesi i institucionit shtetëror, ndërmarrjes apo shoqërisë shtetërore, ku të jenë përcaktuar qartë sipërfaqja e truallit gjithsej, sipërfaqja nën ndërtesë dhe sipërfaqja funksionale (jo nën ndërtesë).”.

3. Pas pikës 8, të kreut III, “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë”, shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Për tunelet dhe vendstrehimet që jepen me qira, tarifa dysheme e detyrimit mujor e përcaktuar në aneksin “A”, bashkëlidhur këtij vendimi, pjesëtohet me 5”.

4. Në kreun V, “Kontrata me tarifën simbolike 1 euro/kontrata”, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 2, 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Kur pas përfundimit të procedurave të konkurrimit rezulton fitues një subjekt, i cili propozon që në pasurinë shtetërore, që jepet me qira, do të zhvillojnë një prej veprimtarive të mëposhtme:

a) veprimtari prodhuese, me nivele investimi mbi 300 000 000 (treqind milionë) lekë;

b) përpunim aktiv të mallrave, që do të sigurojnë jo më pak se 50 vende pune;

c) veprimtari të agrobiznesit, si: grumbullim, përpunim dhe shitje të produkteve bujqësore ose blegtorale, me nivele investimi mbi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë;

Institucioni, që zhvillon procedurën dhe që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit shtet për pasurinë shtetërore, i propozon Këshillit të Ministrave të miratojë lidhjen e kontratës së qirasë, jo me çmimin fitues, por me çmimin simbolik 1 (një) euro/kontrata. Propozimi shoqërohet me projektkontratën e negociuar ndërmjet palëve.

3. Ministria përgjegjëse për ekonominë propozon në Këshillin e Ministrave dhënien me qira të pasurisë shtetërore pa konkurrim dhe me çmimin simbolik 1 (një) euro/kontrata, kur me ofertë “të pakërkuar” kanë propozim për zhvillim zone vetë veçanta, duke investuar vlera mbi 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, me qëllim ngritjen e qendrave të organizuara sociale që ndikojnë për zgjidhjen e problemeve sociale ose për ushtrim të veprimtarive në fushën e sportit a të kulturës apo në fushën e turizmit ose të trashëgimisë kulturore.

4. Para nënshkrimit të kontratës së qirasë, me tarifë 1 euro/kontrata, qiramarrësi është i detyruar të kryejë pagesën e garancisë së kontratës, në masën 2 për qind të vlerës së investimit të marrë përsipër në konkurrim. Garancia kthehet pas përfundimit të çdo faze të investimit, por jo më shumë se në tri këste, sipas fazave të investimit. Forma e ngurtësimit të garancisë së kontratës përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për ekonominë.

5. Në kontratat me tarifë 1 euro/kontrata vendosen sanksione për rastet kur qiramarrësi nuk realizon kushtet e saj. Për çdo vend pune të pahapur subjekti qiramarrës do të ndëshkohet me 50 000 (pesëdhjetë milionë) lekë në vit. Për mosrealizim të investimit në përfundim të fazës përkatëse ndëshkohet me 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar në atë fazë dhe nëse pas 6 muajve investimi nuk realizohet, kontrata zgjidhet nga institucioni shtetëror që e ka lidhur atë, duke marrë gjobë, në masën e garancisë së depozituar në atë periudhë.”

b) Pika 7 shfuqizohet.

5. Në paragrafin e dytë, të pikës 6, të kreut VI, “Monitorimi i kontratave”, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Genplanet, që shoqërojnë çdo kontratë, përgatiten sipas përcaktimeve në shkronjën “ç”, të pikës 1, të kreut II, të këtij vendimi.”

6. Në pikën 6, të kreut VII, “Shpërndarja e të ardhurave”, pas përkufizimit “. Autoriteti Portual Durrës ... ” shtohen fjalët “.shoqëritë e trajtimit të studentëve ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**